



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:262031
Datë: 22.02.2023
Numri i dokumentit: 04025795

C.nr.1186/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H. A., nga fshati R. i V., Komuna e Lipjanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat E. M. nga Prishtina, kundër të paditurës “E.” sh.p.k, Magjistratja Prishtinë – Ferizaj, me drejtor të përgjithshëm Sh. U., përfaqësuar me autorizim nga H. R., avokat në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensim dëmi për shkak të lëndimit në punë, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik me datë 16.02.2023 mori, kurse me datë 22.02.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e themeltë kërkesëpadia e paditësit H. A., nga Lipjani, dhe DETYROHET e paditura “E.” sh.p.k, Magjistratja Prishtinë-Ferizaj, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të pësuar për shkak të lëndimit në punë me datë 11.08.2012, t’ia paguaj shumat si vijon:

A. Në emër të dëmit jo material:

- a. Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....3,800.00€
- b. Për frikën e pësuar, shumën prej.....3,000.00€
- c. Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej.....2,800.00€
- d. Për shëmtim trupor, shumën prej.....1,000.00€

B. Në emër të dëmit material:

- a. Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....630.00€
b. Për ndihmë të nevojshme për ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës dhe veshmbathjes, shumën prej.....400.00€

II. DETYROHET e paditura “E.” sh.p.k, Magjistranja Prishtinë – Ferizaj, përfaqësuar nga pronari Sh. U., që paditësit t’ia paguaj kamatën në lartësi prej 8% për pjesën e aprovuar të padisë, ashtu që për dëmin jo material kamata do të rrjedhë nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit 22.02.2023, kurse për dëmin material nga data e paraqitjes së padisë 22.05.2015, deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 350.00€, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit.

III. REFUZOHET si e pathemeltë pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit H. A., nga Lipjani, mbi shumat e aprovuara dhe atë: për dhembjet e përjetuara fizike shumën prej 1,700.00€; për frikën e pësuar shumën prej 500.00€; për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 700.00€; dhe për shëmtim trupor shumën prej 1,000.00€.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij me datë 22.05.2015 ka parashtruar padi kundër të paditurës me objekt të kontestit kompensim i dëmit si pasojë e lëndimit në vendin e punës. Në padi ka theksuar se me datë 11.08.2012, rreth orës 08:00, paditësi edhe pse kishte përfunduar orarin e punës si sigurim fizik i objektit gjatë natës, i njëjti urdhërohet nga njëri prej pronarëve të të paditurës që ta ujisë pllakën në katin e dytë dhe me qenë se ishte fizikisht i lodhur gjatë zbritjes së shkallëve rrëzohet dhe pëson lëndime trupore – fracturë në pjesën e këmbëve dhe duarve. Për shkak të këtij aksidenti paditësi fillimisht ishte trajtuar nga Qendra Emergjente e më pas është shtruar në Klinikën e Ortopedisë, në QKUK, nga data 11.08.2012 deri më 17.08.2012. Lëndimet që ai kishte pësuar i ka

përjetuar si dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shëmtim trupor, shpenzime të mjekimit, etj. Si dhe për shkak të përgjegjësisë së punëdhënësit, i cili e ka urdhëruar paditësin që të kryej punë jashtë orarit dhe punë që nuk i përkasin sipas kontratës, ndaj të paditurës është iniciuar procedurë penale për shkak të veprës penale Rrezikim i sigurisë në punë.

Përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesës së saj duke i propozuar gjykatës që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar, nuk ka pasur vërejtje në ekspertizën e mbrojtjes në punë dhe as në atë mjekoligjore të ekspertit ortoped dhe psikiatër, dhe pas pranimi të njëjtave përfaqësuesi i paditësit ka bërë rregullimin e padisë në kuptimin objektiv për secilën kategori dëmi duke specifikuar shumat kompensuese që i kërkonte.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj ka ushtruar përgjigje në padi duke e kontestuar kërkesëpadinë me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar. Më tej ka theksuar se padia e paditësit është e paqartë dhe nuk dihet se cilat janë arsyet dhe baza ligjore e saj, gjithashtu paditësit i mungon legjitimiteti aktiv i palës në procedurë në raport me të paditurën për shkak se asnjëherë nuk kanë qenë në marrëdhënie civilo-juridike që të mund të krijoheshin të drejta dhe detyrime mes palëve. Po ashtu paditësi me anë të padisë ka kërkuar kompensim të dëmit pa cekur se për cilin dëm, e po ashtu ka kërkuar edhe kompensimin e fitimit të humbur pa cekur se mbi çfarë baze ligjore i mbështet kërkesat e veta. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të paditësit se ndaj të paditurës është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore për veprë penale, e paditura i konteston në tërësi si të pabazuara për arsye se ndaj personit juridik “E.” sh.p.k nuk është duke u zhvilluar kurrfarë procedure për kurrfarë veprë penale, si dhe provat e ofruara nga paditësi nuk kanë të bëjnë me të paditurën (E. sh.p.k – person juridik) por me person tjetër fizik.

Përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i të paditurës ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si nga baza ashtu

edhe nga lartësia, për faktin se i njëjti ka qenë punëtor tek e paditura si roje i objekteve në ndërtim, dhe nuk është lënduar gjatë kryerjes së detyrave të veta sipas kontratës, por është lënduar nga pakujdesia e tij. Më tuje ka shtuar se nuk qëndron konstatimi i ekspertizës së ekspertit të mbrojtjes në punë se paditësi është lënduar për shkak të mungesës të pajisjeve mbrojtëse në punë, ngase paditësi i ka pasur të gjitha masat mbrojtëse dhe pajisjet mbrojtëse për punën të cilën e ka kryer në cilësi të rojës, ndërsa hipja nëpër shkallë dhe në katet e tjera, paditësi nuk ka qenë i pajisur me masa mbrojtëse për to, ngase ajo nuk ka qenë detyrë e tij e punës. Gjithashtu e kontestoj edhe precizimin e kërkesëpadisë nga i autorizuari i paditësit në lidhje me lartësinë ngase gjykata nuk mund të punoj sipas rregullores së BKQ-së dhe nuk janë ata parametra të cilët vlejné për gjykatën.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Fletë lëshimi nr.1307; Kontrata e punës në mes paditësit dhe të paditurës; Ekspertiza e sigurisë në punë e datës 13.01.2020; Ekspertiza mjekoligjore e datës 28.05.2021; Aktgjykimi P.nr.1511/2013 i datës 19.11.2016 si dhe Dëgjimi i palës si mjet provues.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa kontestuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar tek e paditura, i caktuar në detyrat e punës si roje i objektit. Megjithatë, ky fakt vërtetohet sipas kontratës së punës e lidhur mes paditësit dhe të paditurës. Po ashtu gjykata gjeti se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte

kontestues fakti se paditësi përderisa ishte duke punuar tek e paditura, si pasojë e aksidentit në punë ka pësuar lëndime trupore.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet, nëse paditësi ka të drejtë në kompensim për shkak të lëndimeve të marra tek e paditura, ashtu që në njërin anë pala paditëse pretendon se i takon një kompensim i tillë, ndërsa e paditura pretendon se nuk i takon kompensimi, ngase e paditura nuk mund të mbahet përgjegjëse, për këtë në thelb palët kishin pikëpamje diametralisht të kundërta.

Gjykata gjeti se paditësi është dërguar në QKUK-Qendra Emergjente, me ç' rast përpilohet raporti i pranimit si dhe lëndimet që ai pëson. Në raport është cekur se ai ishte sjellë në qendër si pasojë e rënies nga lartësia (shkallët), duke pësuar lëndime trupore. Nga ekzaminimet mjekësore të kryera, vërtetohet se paditësi si pasojë e aksidentit kishte pësuar lëndim të dy duarve dhe të këmbës së majtë, dhe është konstatuar diagnoza: fractura pars distalis radii lat dex, Fractura ossis calcanei sin, fractura caput radii lat sin, ndërsa pas konsultimit me anesteziologun paditësi i është nënshtruar operacionit me anestezion të përgjithshëm në dorën e majtë dhe këmbën e majtë, me datë 14.08.2012. Paditësi si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin në punë, kishte qëndruar në Klinikën e Ortopedisë me Traumatologjinë Lokomotare nga data 11.08.2012 deri me datë 17.08.2012, fakt i dëshmuar përmes fletë lëshimit me nr.1307, të lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK).

Me qëllim të vërtetimit të mënyrës se si janë gjendur palët ndërgjyqëse në këtë aksident, pra vërtetimit të lëshimeve të palëve, gjykata ka caktuar ekspertimin përmes ekspertit për mbrojtje dhe siguri në punë, me ekspert H. N.. Përmes ekspertizës së punuar të datës 13.01.2020, gjykata gjeti se e paditura ka qenë e detyruar të ndërmerr masat për siguri dhe shëndet në punë, duke vendosur shkallë në përputhje me standardin evropian për ngritje dhe zbritje nga kati i dytë, dhe të kompletuara me pareta për mbajtje me duar, që përfshin masat për parandalimin e rreziqeve profesionale dhe dhënien e udhëzimeve të duhura për punë të sigurt. Gjithashtu e paditura ka qenë e detyruar të zbatoi masat

parandaluese, bazuar në parimet e përgjithshme të parandalimit sipas dispozitave të ligjit për siguri në punë, prandaj e njëjta mbahet përgjegjëse për lëndimin e paditësit.

Ekspertiza për mbrojtje dhe siguri në punë e nxjerrë në këtë çështje kontestimore, ka ofruar të dhëna lidhur me përgjegjësinë e ndarë të palëve ndërgjyqëse në përpjesëtim me veprimet që ka qenë dashur t'i ndërmarrin. Gjykata e ka pranuar ekspertizën në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident në punë, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertimit me ekspertë nga lëmia e ortopedisë dhe nga lëmia e psikiatrisë, të cilën e kanë punuar Dr. Xh. S.-ortoped dhe Dr. N. M.-psikiatre.

Eksperti ortoped, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit të ndodhur ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si lëndime të rënda trupore.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike aprovoi kërkesën në shumën prej 3.800.00€, e vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, gjithashtu lëndime të ndryshme. Eksperti ka gjetur se paditësi ka pësuar thyerje të kokës së rrezorit të majtë, thyerje të pjesës së poshtme të rrezorit të majtë si dhe thyerje të thembrës së majtë. Po ashtu përmes ekspertizës është gjetur se paditësi ka pësuar dhimbje me intensitet posaçërisht të lartë për 20 minuta. Kurse dhimbje me intensitet të rëndë 48 orë, herë pas here deri në dhënien e terapisë kundër dhimbjeve. Me intensitet të mesëm 35 ditë, që është kohë e mjaftueshme për konsolidimin primar kockor të kockave të thyera. Ndërsa dhimbjet me intensitet të ulët ende vazhdojnë, në formë të dhimbjeve të byzylykut të dorës së majtë, bërrylit të djathtë dhe thembrës së majtë, të cilat janë më të shprehura në ndryshime klimatike dhe në sforcime fizike, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësin.

Eksperti ortoped ka gjetur se paditësi ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 14.27%, për shkak të thyerjeve të kufizimit të lehtë të lëvizjeve të bërrylit të majtë; kufizim të lehtë të lëvizjeve në byzylykun e dorës së djathtë dhe kufizim të lehtë të lëvizjeve të nyellit të shputës së këmbës së majtë. Prandaj për këtë kategori të dëmit është caktuar shuma e kompensimit në lartësi prej 2,800.00€.

Në emër të shëmtimit gjykata ka caktuar shumën e kompensimit prej 1,000.00€, ngase është vërtetuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pasur shëmtim në shkallë të mesme, për shkak të vrazës me gjatësi 9.5cm x 0.2cm, në njërin skaj dhe x 0.5cm në skajin tjetër, në pjesën e jashtme të parakrahut dhe bërrylit të majtë. Prandaj shkalla e vrazave e justifikon vlerën e kompensimit të caktuar lidhur me këtë shkallë të shëmtimit.

Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka paraqitur se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje 60 ditë, duke përfshirë ndihmën që konsiston në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, mbajtjes së higjienës, veshmbathjes etj., i ndihmuar nga familjarët. Kurse ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 90 ditë, i pajisur me proteina, minerale, vitamina etj.

Për frikën është caktuar shuma e kompensimit në lartësi prej 3,000.00€, pasi që nga eksperti psikiatër është konstatuar se paditësi ka pësuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda në momentin e rrëzimit nga shkallët; Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për 2 ditë, në formë të frikës nga invaliditeti i përhershëm, rikujtimi i ngjarjes traumatike, çrregullim i gjumit, vështirësive të adaptimit me kushtet e trajtimit mjekësor dhe intervenimit kirurgjik; Frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur për 1 muaj, shoqëruar me ankthe, pasiguri, brengë për ecurinë e mjekimit, rënies së disponimit dhe vullnetit me vështirësi të adaptimit me kushtet e imobilizimit mjekësor; Frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka zgjatur për 6 muaj, e shoqëruar me ankthe, mungesë disponimi, nervozë, shqetësimeve gjatë gjumit si dhe pasigurisë së përgjithshme. Gjykata ekspertizën mjekësore: të ekspertit të ortopedisë dhe të psikiatrisë, e ka pranuar në tërësi si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar, po ashtu e

punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Pronari i të paditurës “E.” sh.p.k, Sh. U., është shpallur fajtor për veprën penale Rrezikimi i Sigurisë në Punë, nga neni 186, par.4 lidhur me par.3 të KPK-së, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, pasi që në cilësinë e punëdhënësit në ndërmarrjen “E.” sh.p.k, nga pakujdesia, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, nuk ka marrë masa mbrojtëse për mbrojtjen nga rreziqet në punë, ashtu që i dëmtuari H. A., si punëtor i kësaj ndërmarrje, është rrëzuar nga një lartësi prej rreth 3 metra, dhe ka pësuar lëndime të rënda trupore. Gjykata këtë e vërtetoi nga Aktgjykimi P.nr.1511/13, i datës 29.11.2016.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 16.02.2023, i autorizuari i palës së paditur i ka propozuar gjykatës që të dëgjohet paditësi në cilësi të palës. Gjykata mori Aktvendim dhe e aprovoi propozimin e të autorizuarit të palës së paditur, për dëgjimin e paditësit në cilësi të palës. Paditësi kishte deklaruar se ka qenë i punësuar tek ndërmarrja “E.” sh.p.k, si roje, mirëpo kohë pas kohë nga punëdhënësi është urdhëruar që të kryej edhe punë të tjera. Orarin e punës e ka pasur nga ora 08:00 deri në 18:00, në ndërrimin e ditës, ndërsa në ndërrimin e natës nga ora 20:00 deri në 6:00 në mëngjes, kurse ditën e aksidentit ka qenë në ndërrimin e natës dhe rreth 15 minuta pa e përfunduar orarin e punës është urdhëruar ta ujisë pllakën në katin e dytë, nga ku është rrëzuar prej shkallëve. Këtë deklaram si mjet provues, gjykata e vlerësoi në përputhje me provat tjera, duke gjetur të argumentuar në rrjedhën e ndodhjes së aksidentit.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Ligji nr. 04/L-077 (LMD) e rregullon çështjen e kompensimit të dëmit. Neni 154 i LMD-së, thotë: Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. Kurse neni 154 i LMD-së përcakton se: Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet

se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit. Ndërsa neni 5 par. 1 i Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, përcakton se: Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. Kurse neni 6 par. 1 rregullon se: Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.

Gjykata përmes provave të administruara të cilat dërguan në gjendjen faktike të vërtetuar, gjeti se e paditura mbahet përgjegjëse për shkaktimin e dëmit në këtë rast kontestues, kjo ngase lëndimi i paditësit ka ardhur si pasojë që i njëjti ka qenë duke punuar tek e paditura dhe për llogari të saj, kurse e paditura ka dështuar në ndërmarrjen e veprimeve që mos të vije deri tek fatkeqësia. E njëjta ka pasur për obligim që të organizoj apo ndërmarr masat e nevojshme për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, përfshirë këtu parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimin, organizimin përkatës dhe masave të duhura për të siguruar, mirëmbajtur makineritë, instrumentet, pajisjet etj.

Gjykata gjeti se e paditura nuk ka respektuar obligimet ligjore të parapara me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, të cilat u elaboruan, ndërsa gjykatës nuk i ofroi prova që do të dëshmonin se e paditura nuk mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit, e që do të kishin si pasojë lirimin nga përgjegjësia të të paditurës. Kurse në anën tjetër u gjet se e paditura ka dështuar në ndërmarrjen e masave preventive sipas nenit 18 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Gjykata vë në dukje se tek rastet e dëmit jashtë kontraktual duhet të plotësohen disa kushte siç janë: a) ekzistenca e dëmit, b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit, c) ekzistenca e fajit (me dashje apo nga pakujdesia), dhe d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. Rrjedhimisht, tek

rasti kontestues është përmbushur elementi i lidhjes kauzale apo shkakore, që tërheq pas vetes edhe fajin më pastaj përgjegjësine.

Gjykata vlerëson se tek ky rast përmbushen elementet e lidhjes shkakore që paraqet raportin e ndërsjellët ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij. Pra lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësise për dëmin e shkaktuar, që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Çdo ngjarje që është kusht për dëmin, d.m.th., pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron të paditurin të shpërblej dëmin. Së këndejmi lidhja kauzale duhet të jetë e atillë që duhet të dëshmojë për ngjarjen e cila sigurt është shkaktuar si pasojë e veprimit apo mosveprimit të personit. Përfundimisht, në këtë proces kontestimor, pala e paditur nuk arriti të argumentojë se ka ndërmarrë masat preventive, duke përfshirë informimin e punëtorit-paditësit për rreziqet në vendin e punës, mbajtja trajnimeve etj.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material). Neni 137 i LMD-së thotë: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se: Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Prandaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuar për paditësin, moshën e tij, vlerësimin në ekspertizave mjekësore dhënë mbrojtje dhe sigurisë në punë, miratoj pjesërisht

kërkesëpadinë e paditësit të bazuar në vlerën e shpërblimit të dëmit si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se shumatat e kompensimit të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do të mundësojë paditësit satisfaksion që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po që se të njëjtat nuk do t'i kishte humbur, gjithë kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit, nevojat e shtuara për mjekim, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 14.27%, respektivisht pasojat e lëndimeve më afër të përshkruara si në mendimet e ekspertëve ortoped dhe psikiatër. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe në lidhje me shumën e kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu kriteret e vëna nga praktika gjyqësore.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 630.00€ si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 90 ditë – ushqim i pasur me vitamina, minerale dhe proteina.

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 400.00€ si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për t'i kryer shumicën e aktiviteteve të përditshme jetësore në kohëzgjatje prej 60 ditë.

Gjykata për kategoritë e dëmit ushqim i përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes i huaj, vlerëson se mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore, dhe vështirë i argumentuar. Andaj pas analizimit të gjitha provave, ka ardhur në përfundim se shumatat e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin material dhe jo material gjykata vendosi si në pikën III (tre) të dispozitivit të aktgjykimit duke përfshirë: për dhembjet e përjetuara fizike shumën prej 1,700.00€; për frikën e pësuar shumën prej 500.00€; për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 700.00€; dhe për shëmtim trupor shumën prej 1,000.00€. Për këtë pjesë, është vlerësuar se kompensim përtej shumave të gjykuara, nuk do të ishin në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Duke qenë se pas administrimit të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se paditësit i takon edhe kamatëvonesa, gjykata lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit: Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi të kryesor, edhe kamatën. Për sa i përket dëmit material llogaritja e saj është caktuar të jetë nga dita e parashtrimit të padisë, ngase në shkresat e lëndës nuk është gjetur dëshmi se paditësi pranë të paditurës të ketë parashtruar kërkesë për kompensim, kurse ajo të mos i jetë përgjigjur. Ndërsa për dëmin jo material, rrjedha e kamatës është caktuar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit (në këtë mënyrë edhe Mendimi juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i dt.02.12.2020).

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së dhe atë si në vijim: shpenzimet për ekspertiza dhe atë: psikiatrike 100.00€, ortopedike 100.00€, dhe nga lëmia mjekësisë së punës 150.00€, apo në shumë të përgjithshme 350.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.1186/2015 datë 22.02.2023

Gjyqtari

Përparim Zeka

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.